

VENDIM
Nr. 8/2016

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË
KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR ADMINISTRIMIN
E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjeve dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore, me synim parandalimin e këtij fenomeni negativ për shtetin, qytetarët dhe bizneset dhe nxjerrjen e përgjegjësi konkrete.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1. Kontrolli i zbatimit të legjislacionit tatimor në administrimin e bazave të të dhënave shtetërore nga ana e administratës tatimore për periudhën 12.11.2013 – 7.12.2013.

2. Njohja dhe verifikimi i problematikës së ndërhyrjeve në sistemet tatimore, me qëllim përcaktimin e mënyrës së kryerjes së këtij veprimi, si dhe identifikimin e përgjegjësi nga organet apo personat zyrtar përkatës, me synimin për frenimin me mjete ligjore të shfaqjes së tij në të ardhmen.

3. Njohja me arsyet e mosfunksionimit të sistemeve tatimore për disa ditë, me qëllim parandalimin e kësaj problematike të dëmshme në të ardhmen.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësi institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh, me qëllim ndalimin përfundimtar të ndërhyrjeve të paligjshme në sistemet tatimore dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

V. Komisioni Hetimor Parlamentar përbëhet nga 11 deputetë, me përbërje si më poshtë:

1.	Arben Ristani	(PD)	Kryetar
2.	Ervin Bushati	(PS)	Nënkryetar
3.	Blerina Gjylameti	(PS)	Anëtare
4.	Vasilika Hysi	(PS)	Anëtare
5.	Antoneta Dhima	(PS)	Anëtare
6.	Ervin Koci	(PS)	Anëtar

7.	Përparim Spahiu	(LSI)	Anëtar
8.	Jorida Tabaku	(PD)	Anëtare
9.	Florion Mima	(PD)	Anëtar
10.	Helidon Bushati	(PD)	Anëtar
11.	Sherefedin Shehu	(PD)	Anëtar.

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke venë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që, brenda 5 ditëve nga miratimi i këtij vendimi, t'i kalojë komisionit të gjitha aktet, dokumentet apo informacionet e hartuara apo të administruara gjatë veprimtarisë së Komisionit Hetimor "Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar më thellë fenomenin e ndërhyrjes dhe të bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore", të ngritur me vendimet nr. 81/2014 dhe nr. 89/2015 të Kuvendit të Shqipërisë.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Valentina Leskaj

Miratuar në datën 11.2.2016